

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit U. D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: të detyrimit nga neni 267 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Komunale tani Prokuroria Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.503/10, të datës 28.09.2011, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësor me datën 28.12.2017, 29.01.20..., 05.03.20..., 03.04.20..., 16.04.20..., 04.06.20..., 25.07.20..., në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarve K. D. dhe G. D., të akuzuarit si dhe mbrojtësi të tij av.G. K.nga Peja, me datën 30.07.20... mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M****I akuzuari:**

**U. D**, nga i ati P., e ëma M., e gjinisë N., data e lindjes... në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “....” p.n, i martuar, baba i 4 (katër) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datën të pa përcaktuar të muajit Maj gjerë me datën 01.08.2010, në Gjakovë, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, nën kërcënimin e rëndë se do ta vras atë apo djalin K. D. që të veproj në dëm të pasurisë së vet, i akuzuari U. në emër të parave të dhëna borxh dhe automjeteve të shitura në vlerë prej 91.000 €uro, të dëmtuarit K. D. dhe B. D. me fajde 10% në muaj, duke e shfrytëzuar gjendjen e tyre të vështirë ekonomike dhe financiare, me kanosje të vazhdueshme ka detyruar të dëmtuarit K. D. me djalin B. të e largohen nga Gjakova, edhe pse në emër të fajdesë kishte paguar 145.000 €uro për borxh dhe 21.000 €uro fajde për automjetet e shitura dhe me datën 23.08.2010 i dëmtuari K. detyrohet të ia jep prokurën dëshmitarit M. P. që në emër të tij të lidhë kontratë me të akuzuarin U. D. kinse mbi shitblerjen e shtëpisë në rrugën “.....” nr., me të gjitha pajisjet në ngastrën nr.....me kulturë shtëpi dhe oborr në sipërfaqe prej 0.04.91 ha, të evidentuara sipas certifikatës së Drejtorisë për Kadastër-Gjeodozi dhe pronë me numër ....Gjakovë, jashtë qytetit si kundërvlerë e fajdesë së pa paguar të akuzuarit U. D., në të cilën shtëpi e dëmtuara G. D. është bashkëpronare me 1/5 të pjesës ideale ndërsa A. D. me 2/5 të pjesës ideale duke e lëndë bashkëshorten e të dëmtuarit K. D. N. D. dhe fëmijët e tyre në rrugë.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të detyrimit nga neni 267 par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 2, 3, 11 par.1, 34, 41, 42, 43, 44, 64, dhe nenin 267 par.1 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarin U. D.ia shqipton:

**D Ë N I M I N M E K U S H T**

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarit: K. D., G. D. dhe B. D. që të gjithë nga Gjakova, me banim në rrugën “....” për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

**Detyrohet** i akuzuari U. D., që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjalë përfundimtare e palëve.

Prokuroria Komunale tani Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.503/10, të datës 28.09.2011, kundër të akuzuarit U. D. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: të detyrimit nga neni 267 par.1 të KPK-së dhe kundër të akuzuarve M. D. dhe P. Gj. që të dy nga Gjakova, për shkak të veprës penale kontraktimi i përfitimit jo proporcional nga neni 269 të KPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm me numër P.nr.550/11, të datës 11.04.2017, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 23.05.2017, është hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP.nr. 503/10, e datës 28.09.2011 dhe është pushuar procedura penale kundër të akuzuarve M. D. dhe P. Gj. që të dy nga Gjakova, për shkak të veprës penale kontraktimi i përfitimit jo proporcional nga neni 270 par.1 të KPK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale (ndalesë absolutë mbi ndjekjen penale).

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit U. D. dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari K. D., në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim ka qëndruar në tërësi saj dhe po ashtu ka mbështetur dhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

E dëmtuara G. D., në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim ka qëndruar në tërësi saj dhe po ashtu ka mbështetur dhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit U. D., av. B. H. nga Gjakova, i cili ka marr pjesë vetëm në seancën shqyrtimin gjyqësor të 25.07.20... sipas autorizimit zëvendësues të avokatit G. K. nga Peja, gjatë fjalës përfundimtare gjykatës i ka dorëzuar fjalën përfundimtare av. G. K. të cilën e kishte përgatitur me shkrim ashtu që ka propozuar gjykatës që i akuzuari të lirohet nga aktakuza në mungesë të provave.

I akuzuari U. D., në tërësi është pajtuar me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

### 2. Konstatimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se është vërtetuar se i akuzuari U. D., me dashje kryer veprën penale të detyrimit nga neni 267 par.1 të KPK-së.

### 2. Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë procedurës së provave ka dëgjuar dëshmitarët: K. D., B. D., G. D., M. P., A. D., I. A., F. M., N. D., si dhe ka administruar provat që janë propozuar nga palët dhe atë: Lexohet kontrata e shitblerjes së patundshmërisë e datës 25.08.2010, shkresa në emërtimin prokura e posaçme me numër ... të datës 24.08.2010, deklarata e M. P.t me numër ...e datës 13.09.2010, e vërtetuar pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë, kontrata mbi shitblerjen e automjetit me datën 26.03.2010, kontrata mbi shitblerjen e automjetit e datës 17.05.2010, kontrata mbi shitblerjen e automjetit e datës 26.03.2010, lexohet raporti i oficerës L. Sh. me numër 2010-DB-1349 e datës 22.09.2010, lexohet certifikata mbi të drejtën e pronësisë së paluajtëshmërisë me numër ... e datës 22.09.2010, lexohen shkresa me emërtimin lista e borxheve ku si dhënë është U. D. ndërsa marrës është B. D., raporti i ekspertimit të Agjencionit Kosovarë për Forenzikë me numër ... i datës 17.05.20... së bashku me CD-në në formë të kopjes ku shihet mesazhi nga numri i telefonit ....

## 2.1 Deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1 I dëmtuari K. D., në cilësi të dëshmitarit, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: gjatë vitit 2009 përderisa kam qenë duke ndërtuar një objekt, më është ofruar U. D.dhe më ka thënë a ke nevojë me të dhënë para me fajde. Meqenëse kam qenë duke ndërtuar një objekt banesor dhe nuk kamë pasur mjete financiare kam marrë nga U. një vlerë të parave që tani saktësisht nuk më kujtohet për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë 9 vite. Kur i kam marr paratë e kam pas të caktuar 10% shumën që duhet të ia kthej paratë këtij p.sh: i kam marr 10.000 Euro dhe për sa kohë i kam marr këto para është dashur që t'ia jap muaj për muaj 10% si dhe shumën e parave të cilën i kam marrë. Por përveç parave kur është ofruar data e 10 pra e interesit për paratë që nuk janë kthyer së pari ka ardhur vëllai M. D. dhe pastaj i akuzuari U. D.dhe na kanë ofruar makina me interes. Interesi për makinën e sjellë ka qenë 10.000 Euro dhe dy ditë para se të ofrohet 10% interesit-mujores ka ardhur dhe ma ka kërkuar, nuk kam pasur mjete që të ia kthej dhe ai më ka marr makinën në vlerë prej 10% të interesit dhe më ka ngarkuar që të paguaj dhe shumën që e ka marr në vlerë prej 10.000 Euro. Ai ka shtuar se sa herë që ka ardhur afati i pagesës së fajdes-intersit është ofruar vëllai i tij ose miku i vëllait të tij P. Gj., dhe mi kanë ofruar makinat të cilat kanë qenë vetura të akuzuarit, të vëllait të tij M. D. dhe mikut të M.s P. Gj.. Ai ka shtuar kam dhënë një prokurë tek noteri në Tiranë dhe ia kam dërguar në Gjakovë tek i autorizuari im M. P., arsyeja ka qenë se i akuzuari U. D.nga unë ka kërkuar prapë fajde duke thënë se është rritur vlera dhe duke më dërguar mesazhe telefonike kërcënuese sa që jam detyruar të shkoi në Stacionin Policor në Tiranë që ta paraqes numrin tim të telefonin për të ditur për numrat që më kanë kërcënuar nga se ai ka bërë një gjë të tillë me lloj lloj numrash. Pas një kohe policia e Tiranës ka vërtetuar se kush fshihet prapa atij numri dhe ka ngritë padi në Prokurorinë e Tiranës në të cilën kam qenë i ftuar dhe jam intervistuar duke më treguar se atje do të mbahet seanca për këtë cenim. Ai ka shtuar se në të njëjtën kohë ka qenë i kërcënuar edhe djali im B. i cili me dijeni të prokurorit e ka dorëzuar numrin në Prokurori të Gjakovës dhe unë asnjë kontratë nuk e kam nënshkruar dhe nuk kam asnjë lloj dëftese që më ka dhënë para dhe ma ka blerë shtëpinë ose më ka dhënë diçka për shitjen e shtëpisë e duke i parë këto kërcënime e kam autorizuar M. P.n duke i thënë se meqenëse po kërkon shtëpinë ... me kërcënime, po ta dërgoi prokurën por në atë shtëpi është hisetarë motra ime G., gjithashtu shtëpia është në hipotekë në bankë. Por pavarësisht kësaj ai mi ka marr çelësat e shtëpisë është futur në shtëpi U. D. dhe bashkëshortja dhe fëmijët kanë dalë në rrugë. Për atë sa kam dijeni M. P., nuk ka vepruar sipas prokurës. Shtëpija ime gjendet në rrugën “...” nr..... I akuzuari U. D.shtëpinë e ka mbajtur saktësisht kohën nuk e di por e ka mbajtur mund të them 2 deri në 3 vite, dhe i njëjti ka banuar në këtë shtëpi në këtë shtëpi dhe gruan dhe fëmijët e mi i ka larguar nga shtëpia dhe një dhomë të shtëpisë ka qenë e shtruar me llaminat dhe e ka hekur dhe e ka shtruar me pllaka. Tani nuk e mban këtë shtëpi nga se data nuk më kujtohet por ka qenë një vendim i Eulexit dhe Prokurorisë së Gjakovës dhe i Njësis Rajonale në Pejë dhe nga ajo datë U. D.është larguar nga shtëpia dhe unë jam kthyer në atë shtëpi. Ai ka theksuar se kam shkuar në Tiranë së bashku me djalin tim

B., për faktin se nuk kam arritur të ti paguaj borxhin e fajdeve dhe filluan kërcënimet së pari ... duke i telefonuar djalin dhe duke i thënë se kam me të futë në bagazh, nesër kam me ta mbyll dyqanin si dhe llojlojtë kërcënime tjerash dhe për këto arsyeja jemi detyruar që të ikim dhe të shkojmë në Tiranë-Shqipëri. Ai ka shtuar se për këtë kam përpiluar një dokument dhe këtë e ka përpiluar vetë i akuzuari U. D. dhe këtë dokument unë ia kam dorëzuar prokurorisë dhe në atë dokumente shënohet saktë vlera e parave që i kam marrë përqindja e asaj vlere dhe data se kur duhet ti paguaj unë fajden në muaj, dhe ky dokument ekziston në prokuroria. Ai ka shtuar se nuk e kam autorizuar për para kontratë nga se kjo nuk është cekur në prokurë, me vetë faktin që gjithë shtëpia nuk është e imja dhe për këtë kam qenë i vetëdijshëm që nuk mund të bëjë para kontrata por më kanë kërcënuar dhe gjithqysh e duam shtëpinë atëherë ia kam bërë një prokurë që ti iki kërcënimeve dhe ta qetësoi situatën dhe kjo pa qenë për shkak të presionit dhe nuk ka qenë dëshira ime. ... D. ka qenë në dijeni që shtëpia është në emër të motrës dhe që është në hipotekë bankare dhe më presion duke ma kërkuar domosdoshmërisht shtëpinë atëherë unë e kam nënshkruar prokurën dhe po ashtu M. P. i cili punon në kadastër ka qenë në njohuri që në fletë posedim janë të shënuar të gjithë këto. Ai ka shtuar se përveç U. D. kam pasur borxh edhe dy personave tjerë por në Shqipëri kam ikur për shkak të presionit të U. dhe kur ka kaluar rasti im tek Eulexi pastaj jam kthyer në shtëpi.

Ai ka shtuar se nuk e ka njoftuar G. D. dhe bashkëshorten e tij për prokurën që ia ka bërë M. P. t. Me U. nuk kam pasur ndonjë bisedë konkrete lidhur me borxhin, por kur e ka hapur telefonin ka pasur sharje dhe mesazhe kërcënuese, dhe nuk e kam ditë personin kush është dhe kush mi bënë këto kërcënime dhe rastin e kam paraqitur në Polici të Tiranës të cilët ma kanë marrë numrin në përgjim dhe është vërtetu se vjen nga U. D. Kam biseduar me U. para se të shkoi në Tiranë ndërsa kontaktin për prokurë e ka pasur vetëm me M. P..

2.1.2 I dëmtuari B. D., në cilësi të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: të akuzuarin U. D. e njoh. Nga ... kemi marr borxh së bashku me babën por shumicën e rasteve kemi marr makina. Borxhin e kemi kthyer edhe më shumë se sa vlerën e borxhit duke llogarit kamatën e fajdesë, p.sh 10.000 Euro të cilën në ato momente ... ma ka blerë prapë me para pra në qoftë se makina ka qenë në vlerë prej 10.000 Euro, ... ma ka vlerësuar në 4.000 Euro dhe më ka dhënë borxh kuptohet pjesën tjetër dhe shumicën e rasteve nuk kam përpiluar me shkrim por kanë qenë vetëm marrëveshje gojore. Ai ka theksuar se jemi detyruar që të ikim që ta lëshonim qytetin, shtëpinë dhe të shkojmë në Shqipëri dhe kemi qenë të detyruar të ikim në Shqipëri nga .... Kemi pasur edhe një rast lidhur me vëllain e U. – M., djalin e U., i cili gjendet në Zvicër si dhe P., të cilët me kanë ndjekur në B. të R. afër Hotelit “.....”, më kanë zbrit nga automjeti, më kanë mbajtur 2 orë e gjysmë në bagazh duke më sjellë herë në fshatin N. dhe herë nëpër qytete duke më thënë se nëse nuk vijmë babai dhe halla me e nënshkruar tokën dhe me na kthyer paratë nga se është rritur shuma e tyre ngase ata thonin se këto para i kanë marr në Shqipëri nga dikush tjetër dhe unë nuk kam pasur zgjidhje tjetër dhe atë ditë babai imë nuk ka qenë në Gjakovë dhe kam qenë i detyruar që të shkoi tek M. P. i cili e ka pasur lokalit tek “K.-i, dhe aty ka dal M. dhe i kam treguar për rastin dhe M. ka biseduar një herë me babain tim dhe ka marr përgjegjësi që nesër unë ju takojë me babain tim K., veç lëshoni djalin. Ai thekson se nuk e kam lajmëruar rastin në polici sepse kam qenë i kërcënuar dhe për këtë po e them një rast tjetër përderisa kam qenë me vjehrrin tim- babain e gruas me veturën mua personalisht më ka ndal ... në Qendër tek Hotel “.....” dhe më ka zbrit prej kerrit dhe më ka marr veturën e vjehrrit tim. Dhe unë i kam thënë U. se qyre se vjehrrin imë po donë me paraqit rastin në polic dhe pastaj ... mu ka përgjigje se le ta paraqet rastin se unë i kam njerëzit në polici. Ai ka theksuar se në Shqipëri kemi ikur me babain tim K. D. nga se kemi qenë të kërcënuar duke filluar nga ... i cili më ka shkruar mesazh në telefon në numrin ..., dhe më ka thënë po nuk i prunë parat e fajdesë sot kam me të futë në gepek dhe sendet tjera.

2.1.3 E dëmtuara G. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: nuk e kam njohur U. D, më parë vetëm kur e kam takuar para shtëpisë dhe të njëjtin e kam pyet se a je ti që e ke marrë këtë shtëpi dhe i njëjti më është përgjigje se kush je ti dhe atëherë jam përgjigjur se unë

jam pronarja e shtëpisë. Ajo ka theksuar se ka qenë tek shtëpia e K., e cila gjendjet në rrugën “...” dhe e di që ... më ka thënë se shko në polici ashtu që unë vetëm isha në polici, ashtu që i njëjti vërtetë e kishte rregulluar situatën aty dhe unë edhe pse kam pritur që shtëpia të lirohet brenda disa orëve nuk i kam ditë dokumentet 5 muaj atë ditë i kam pyetur në polici, dhe ata më thanë se janë në prokurori. Rastin e kam paraqitur në polici nga se shtëpia ka qenë në emrin tim dhe të vëllait dhe kjo ka qenë edhe me dokumentacion. Ashtu që i akuzuari U. D. ka hyrë në shtëpi duke i bërë presion vëllait tim dhe djalit të vëllait B., por unë personalisht nuk kam pasur ndonjë presion nga se nuk e kam njohur më parë. Në atë kohë K. ka qenë në Tiranë, ka ikur për shkak të fajdeve ku ka falimentuar dhe për shtëpinë nuk e kam ditur që do ta merr dikush dhe as nuk e kam ditur dhe menduar se pa pëlqimin tim mund ta merr shtëpinë dikush. Çelësat e shtëpisë ia ka dorëzuar bashkëshortja e K. N. M. P., edhe pse unë nuk kam dashur që ti jap çelësat por N. ka kundërshtuar nga se kishte frik për djalin e saj B. që mos po i bëjnë diçka dhe ajo më ka thënë se i kanë thanë djalit B. se të marrim dhe të ngrehim zhag me makinë nëse nuk e lëshon shtëpinë, dhe një herë B. e kanë kindapuar. për disa orë M. D., P. Gj. dhe djali i U. D.. Këtë kërcënim e ka bërë ... dhe me sa më duket e ka bërë përmes telefonit por unë këtë kërcënim personalisht nuk e kam dëgjuar, K. më ka thënë se ka paguar rregullisht fajden U. aq shumë që e tejkalon vlerën e asaj që ka marr pra dyfishin e asaj që ka marrë. Shtëpia është ende në emrin tim dhe të K.. U. D. pasi që janë dorëzuar çelësat nga M. P. ka hyrë të banoj në atë shtëpi dhe ka qëndruar rreth 15 deri në 16 muaj. Ajo ka shtuar se mua personalisht K. dhe B. për kërcënimet që ka pas nga ... para se të shkojnë në Shqipëri nuk më kanë treguar por këtë e kam kuptuar pasi që ata kanë shkuar në Shqipëri dhe pasi që janë dorëzuar çelësat dhe nuk e di sa para i ka pasur borxh K. U.

## 2.2 Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1 Dëshmitari M. P., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: U. D. e njoh si figurë, kemi qenë të njëjtit fshatë meqenëse prindi imë ka dalë në Gjakovë nga fshati N. nga i cili fshatë është edhe U. D.. Ai ka theksuar se ia kam bërë kontratën U. D. në bazë të autorizimit që ma ka dërguar K. D. dhe ky autorizim ka pasur si objekt shtëpinë e K. D. dhe unë si i autorizuar e kam bërë një kontratë me U. D. Ashtu që autorizimin e kam pasur vetëm për atë shtëpi. Nuk më kujtohet se sa ka qenë shuma e kontratës së shitblerjes por e njëjta ka qenë e nënshkruar nga ana ime por e di që nuk ka qenë e legalizuar. Paratë lidhur me këtë kontratë unë personalisht nuk kam pasur lidhje me këto para por vetëm e kam nënshkruar këtë kontratë dhe nuk e di se si është blerë dhe as se si është shitur. Ashtu që roli imë ka qenë vetëm që të lidhi një kontratë private dhe këtë kontratë e kemi nënshkruar unë dhe U. D.. Nuk më kujtohet se a ka qenë e paraparë që të i dorëzohen edhe çelësat e shtëpisë U. D. në këtë kontratë. Nuk më kujtohet që çelësat e shtëpisë më janë dorëzuar mua personalisht. Lidhur me prokurën unë nuk kam qenë prezent kur është bërë kjo prokurë dhe K. vetë më ka treguar se don me ia përkthyer shtëpinë U. D. dhe K. nuk më ka thënë se ka pasur kërcënime nga U. D, por i njëjti më ka thënë se i ka borxh U. por nuk e di shumën e borxhit. K. pat ikur në Shqipëri për shkak të borxheve dhe e di që i ka pasur borxh U. D..

2.2.2 Dëshmitari A. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: U. e njoh si figurë nuk kam pasur ndonjë kontakt me të, vetëm dy herë kam pasur kontakte me të, në sallonin e mobileve ku ka punuar vëllai K., aty ka ardhur ... me një person tjetër nuk më kujtohet se kush ka qenë. Nuk kam pasur dijeni se pse ka ardhur, dhe hera e dytë ka qenë kur ka ardhur në oborrin e shtëpisë dhe ka filluar të qelë temelin e shtëpisë dhe aty i kam ndërpre punën ... nga se ... më tha vëllai i juaj më ka borxh, dhe unë kam dëshirë që të takohem me K.. Kemi shkuar me U. së bashku në Tiranë që ta takojmë K. dhe djalin e vëllait B.. K. ka shkuar në Tiranë për shkak të presioneve prej U., ... është vendosur 13 deri në 14 muaj në shtëpinë e K. dhe në shtëpi ka hyrë për shkak të një borxhi që ka pasur K. U. për shkak se i kishte mbetur mangut fajdes dhe këtë po e them nga se ... në prezencën e vëllait të djalit të tij më ka thënë se K. muaj për muaj ka marr fajde nga ai dhe nuk e din pse i ka marr këto para. Nuk e di që K. ka pasur borxh edhe ndaj

dikujt tjetër nga se nuk më ka treguar dhe për kohën në Kosovë nuk më ka treguar se ka qenë i kërcënuar nga ... dhe pasi që ka shkuar në Tiranë dhe ka ikë na ka treguar. Ai ka theksuar se në shtëpinë e K. D. para se të hy ... ka banuar K. me familjen e tij kështu që kur ka hyrë ... në shtëpi nuk ka qenë në Kosovë, ka qenë në Tiranë.

2.2.3 Dëshmitari I. A., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: K. D. e njej si figurë, e di që i ka pasur borxh U. D., por sa ka qenë ajo shumë unë nuk e di, e di vetëm faktin kur A. D. na ka thirr neve së bashku me U. i ka thënë se kam marr vesh se djali i vëllait tim pra ka pasur fjalën për K. ka një borxhe dhe sa më kujtohet ka qenë një shumë prej 30-40.000 Euro nuk jam i sigurte dhe U. D. më kujtohet se i ka thënë baca A. ai më ka më shumë nga se A. kish ardhur me një çelim që të ia lajë borxhin e K. U., dhe më kujtohet se pastaj jemi takuar edhe në restorantin "... " në Q.-Gjakovë, ku ka ardhur edhe K. dhe kanë filluar bisedën dhe ... ia ka prezantuar e di ia ka prezantuar borxhin që ia ka K. në vlerë prej 169.000 Euro apo 170.000 Euro nuk më kujtohet saktë dhe aty e ka kuptua baca A. se nuk ka mundësi që të ia paguaj borxhin K. ndaj U. nga se edhe K. aty e ka pranua borxhin të cilin ia ka prezantuar ... dhe mbaj mend se aty sa kam qenë unë ... i ka thënë se 10.000 euro, meqenëse ke ardhur me bacën A. unë po ti fali po e zë kishe e ke thyer një kerr dhe sa ka mbetur ajo pjesë e borxhit nuk e di dhe K. iu ka drejtuar U. se a kam drejtë me iu thënë të tjerëve se më ki falë 10.000 euro, unë kaq di prej aty jemi qua dhe më ka thirr edhe një herë A. D., po atë ditë në hotel "... " tek ..., në Gjakovë, dhe na është falënderuar mua dhe U. duke na thënë faleminderit por unë nuk e kam ditë dhe nuk kam mundësi që të e paguaj këtë borxh. Nuk më kujtohet që kemi bërë ndonjë marrëveshje me shkrim. Ai ka shtuar se nuk e kam parë U. duke e kanosur K. apo djalin e tij, e di që ... shtëpinë e ka marr nga K. nga se në atë kohë kam ndjekur disa herë aty dhe ai më ka thënë se ia kam marr në emër të borxhit dhe më ka thënë se i ka edhe dokumentet por nuk e di në bazë të çfarë dokumenti.

2.2.4 Dëshmitari F. M., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: K. D. e njoh pasi që i njëjti ka pasur një dyqan të mobileve. Ai ka theksuar se kam qenë duke pirë kafe së bashku me U. n së bashku, kemi shkuar në ..., aty ka qenë ..., unë, I. dhe një shok tjerë N. i cili nuk ka qëndruar aty nga se ka shkuar se ka pasur të punoi. Ai ka shtuar se unë kam qenë në tavolinë tjetër afër tavolinës ku ka qenë A. nga se pastaj kanë ardhur edhe disa persona tjerë në tavolinën e A. pra kanë ardhur K. i, M. dhe L. B. dhe unë nuk kam qëndruar në atë tavolinë kam qenë në një tavolinë tjetër, afër. Ai ka theksuar se unë nuk kam qenë në të njëjtën tavolinë por kam dëgjuar aty se është fole për një borxh rreth 150.000-deri në 160.000 Euro.

2.2.5 Dëshmitarja N. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: të dëmtuarin K. D. e kam bashkëshort, jetoi së bashku qe 31 vite, nuk kam qenë në dijeni për të gjitha veprimet e tij por vetëm me rastin kur më është dashur që ta liroi shtëpinë. Ajo ka theksuar se ka qenë fundi i Gushtit 2010, për shkak se djali më ka thënë se i akuzuari iu ka dhënë para me fajde dhe për shkak të presionit duhet me e liruar shtëpinë për shkak se i ka dërguar disa mesazhe kërcënuese se do të ju ngrehi zhag dhe do të iu shti në makinë por edhe në disa raste tjera, që nuk i di dhe se nuk më kanë treguar mua për këtë gjë ashtu që është dashur me vajzat e mia që të largohem nga shtëpia dhe vetëm me rrobat jemi larguar nga shtëpia. Ajo ka theksuar se nuk e din që i ka pasur borxh bashkëshorti dhe djali të akuzuarit. Përderisa kanë qëndruar në shtëpinë time me vajzat dhe pastaj kur një person i cili për mua ishte i panjohur ka ardhur dhe mi ka kërkuar çelësat e shtëpisë dhe pastaj unë kam shkuar tek vjehrra dhe atij personi ia kam dhënë çelësat. Çelësat ja kam dhënë për shkak se bashkëshorti im kishte bërë një kontratë për shkak të frikës së djalit. Personit të cilit ia kam dorëzuar çelësat ka qenë i panjohur por mbiemri i tij ka qenë P., dhe ky person nuk ka qenë më parë në shtëpinë tonë. Të akuzuarin U. D. nuk e kam njohur asnjëherë por tani e njoh për rastin në gjykatë. Rasin në polici e ka paraqitur kunata ime G. D. për shkak se ajo e ka ditur se i akuzuari i ka dhënë para me fajde bashkëshortit tim. Ajo ka theksuar se para se bashkëshorti imë K. të shkoi në Shqipëri e di një rast kur vëllai i të akuzuarit M. ka ardhur në shtëpinë tonë dhe më ka thënë se kam me iu pre dhe kam me iu bë gjësende të ndryshme por tani

nuk më kujtohet por e di që ai ka ardhur. Pasi që ne e kemi liruar shtëpinë në shtëpi ka qëndruar U. D.dhe ka qëndruar sa më kujtohet mua 1 (një) vit e 2 (dy) muaj.

### 2.3. Provat materiale

2.3.1 Nga leximi i para kontratës së shitblerjes së patundshmërisë e datës 25.08.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari K. D. të cilin e kishte përfaqësuar M. P., përmes prokurës së posaçme me numër ... të datës 24.08.2010 të vërtetuar tek notarija H. G., në cilësi të shitësit, blerësit këtu të akuzuarit U. D.nga Gjakova ia shet pjesën ideale e 2/5 të patundshmërisë e cila është evidentuar në ngasjen kadastrale me numër ....me kulturë shtëpi dhe oborr në Gjakovë, të cilën para kontratë e kishte nënshkruar përfaqësuesi i autorizuar i prokurës M. P. dhe në cilësi të shitësit dhe U. D. në cilësi të blerësit para avokatit T. B. nga Gjakova.

2.3.2 Nga leximi i shkresa në emërtimin prokura e posaçme me numër ... të datës 24.08.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se K. D. ia kishte dhënë M. P.t që ia kishte dhënë të drejtat dhe kompetencat të plota që në emër të tij dhe në llogari të tij të kryej veprime juridike dhe administrative siç janë: të përfaqësoi në të gjitha institucionet shtetërore, zyrën e pasurive dhe paluajtshmerive në Gjakovë, të tërheq vërtetimin e pronësisë në emër të tij të nënshkruar kontrata të shitblerjes në cilësi të shitësit ku është pronar i dy paluajtshme rive ku është pronar i të dy pasurive të paluajtshme, me emërtimin apartamentit banimi me oborr dy katëshe e ndodhur në rrugën “...” si dhe dyqani i ndodhur në rrugën “.....” një katëshe kati I.

2.3.3 Nga leximi deklarata e M. P.t me numër ...e datës 13.09.2010, e vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë, gjykata ka vërtetuar faktin se M. P. kishte vërtetuar një deklaratë pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë me numër .... duke deklaruar se garantoj se K. D. nga Gjakova ia ka shitë blerësit U. D. nga Gjakova, pjesën ideale të paluajtshmerisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr. ....me kulturë shtëpi dhe oborr në sipërfaqe të përgjithshme prej ....sipas fletëposedimeve me numër 32 Zona Kadastrale Gjakovë. Shitësi blerësi ia ka dhënë paluajtshmerinë në shfrytëzim dhe çelësat e shtëpisë.

2.3.4 Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen e automjetit me datën 26.03.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se në mes të shitësit P. Gj.dhe blerësit B. D., ku dëshmitarë kishin qenë Gj. Gj dhe M. D..

2.3.5 Nga leximi kontrata mbi shitblerjen e automjetit e datës 17.05.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se ishte lidhur kontratë mbi shitblerjen e automjeteve në mes të shitësit P. Gj.dhe blerësit B. D.ku në këtë kontratë kishte qenë dëshmitarë K. D..

2.3.6 Nga leximi kontrata mbi shitblerjen e automjetit e datës 08.03.2010,Gjykata ka vërtetuar faktin se është lidhur kontratë mbi shitblerjen e automjetit në mes të shitësit P. Gj.dhe blerësit B. D.ku dëshmitarë kishte qenë M. D..

2.3.7 Nga leximi i raporti i oficeres L. Sh. me numër 2010-DB-1349 e datës 22.09.2010, gjykata ka konstatuar se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore të oficeres L. Sh..

2.3.8 Nga leximi i certifikatës mbi të drejtën e pronësisë së paluajtshmerisë me numër ... e datës 22.09.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo pronë evidentohet në emër të A. D.t, G. D.t dhe K. D.t ashtu që 2/5 e kësaj prone i takon të dëmtuarit K. D. ndërsa 1/5 e sajë i takon të dëmtuarës G. D., ashtu që kjo pronë kishte qenë nën hipotekë.

2.3.9 Nga leximi i dy shkresave me emërtimin lista e borxheve ku si dhënë është U. D.ndërsa marrës është B. D., gjykata ka konstatuar se në këto dy shkresa janë mbajtur evidencë nga i akuzuari U. D.lidhur me borxhet e marra nga B. D.dhe K. D..

2.3.10 Nga leximi i raportit të ekspertimit të Agjencinë Kosovare për Forenzikë me numër ...i datës 17.05.20... së bashku me CD-në, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes numrit të telefonit ..., i cili numër kishte qenë numri i telefonit të akuzuarit U. D.i cili përmes mesazhit “o ti je ka lyp me të ardh me të shti në gepek të kerrit e me të tregu pse nuk e hap telin” me këtë mesazh iu kishte drejtuar të dëmtuarit B. D..

#### 2.4 Mbrojtja e të akuzuarit

2.4.1 I akuzuari U. D.gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se: K.in nuk e kam njohur si person dhe nuk e kam ditë se çfarë pune bënë nga se vetë ky ka ardhur në hotel “...”, së bashku me F. Z. dhe sa e mbaj në mend ai ka qenë takimi i parë mes meje dhe K., po atë ditë nuk e kam ditë se çfarë pune bënë por herë tjetër kur ka ardhur K.i vetë më ka treguar se merret me mobilieri. Ai ka shtuar se kanë ardhur dhe më kanë kërkuar para K. përmes F. që kinse unë e njoh F. dhe më ka kërkuar para, duke më thënë se unë e kam fitimin e fortë dhe ti ke provizion prej tyre dhe atëherë më ka kërkuar dhe në prezencën e F. Z. mi ka marr shumën prej 15.000 ( pesëmbëdhjetëmijë) Euro dhe në të njëjtin muaj i njëjti prapë i ka marrë edhe 5.000 (pesëmijë) Euro në prezencën e F. Z., pra këto dy shuma kanë qenë në Dhjetor të vitit 2008 ndërsa në Janar të vitit 2009 K.i ka marr nga unë edhe 10.000 (dhjetëmijë) Euro të tjera. Ai ka shtuar se ai më ka marrë me datën 15.03.2009, janë bërë afër 75.000 (shtatëdhjetepesëmijë) Euro dhe këto para janë bërë me nënshkrimin e djalit të vetë B.t të cilin edhe ai si borxhe dhe për këtë unë ia dorëzoi edhe gjykatës një shënim që e kam mbajtur për këtë rast. Ai ka shtuar se më ka marr edhe herëve tjera por tani nuk i kam shënimet nga se unë i kam pas shënimet e sakta por në atë kohë jam arrestuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë dhe më është caktuar masa e arrestit shtëpiak dhe unë jam arrestuar me planin e Kryeprokurores së kësaj Prokurorie duke e ditur që jam kryesisht i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohem dhe kur kam qenë në Shqipëri pasi që jam liruar nga arresti shtëpiak kam qenë për qejf më është thyer shtëpia ime pra më është vjedhë ku edhe më është vjedhur edhe i tërë dokumentacioni që kam pas shënimet me nënshkrimet të K.it dhe djalit të tij B.t, dhe K.i e din fortë mirë së bashku me kryeprokuroren dhe Sh. H. se kush mua ma ka vjedhur shtëpinë. Ai ka shtuar se shuma e borxhit të cilën K.i ia ka borxh është 169.000 (njëqindgjashtëdhjetë nëntëmijë) Euro, dhe nga kjo shumë unë ia kam falë edhe 10.000 (dhjetëmijë) Euro në prezencën e F. M., I. A.t dhe M. P.t, dhe tani shuma e borxhit është 159.000 (njëqindpesëdhjetë nëntëmijë) Euro nga se për këtë arsye edhe ma ka dhënë shtëpinë. Ai ka shtuar se K.i i ka thënë se unë të rri karshi për çdo borxh dhe nëse të lyp para H. apo djali imë B. jepi cili të lyp para apo veturë nga se unë të rri karshi. Ai ka shtuar se djalit të K.it ia ka dhënë 13 kerre, këtë gjë K.i e ka ditur dhe unë asnjëherë nuk ia kam dhënë B.t kerret pa e ditur edhe K.i. Ai ka shtuar se K.i për një kohë ka humbë, unë nuk e kam ditë se ku ka qenë, por mua në lokal më ka ardhur I. B. dhe M. P. ku më kanë thënë se K.i është në Tiranë dhe ka borxhe mbi 1.000.000 (një milion) Euro, dhe I. B. dhe M. P. më kanë thënë se je i vetmi që nuk e ke kërcënua andaj K.i do me ta dhënë shtëpinë për borxhin që e ka dhe unë në fillim e kam refuzua nga se shtëpia nuk e ka pas as gjysmën e vlerës së borxhit të arritur të K.it dhe nuk kisha interes që të ia marr shtëpinë që ishte në një kulme me dikën tjetër nga se shtëpia e K.it ka qenë në një kulm me vëllain e vetë. Ai ka shtuar se ka ardhur M. P. tek unë dy tri herë duke më bërë rigja që merrja shtëpinë K.it se nuk ka tjetër zgjedhje dhe mos të ia merr tjetër kush, dhe pastaj M. ka folur me K.in dhe i ka thënë K.it se unë ta qoj autorizimin por nuk kam para as me të e dërguar autorizimin dhe mua më ka thirr M. dhe së bashku me të kemi shkuar në W.U. dhe ia kemi dërguar 100 (njëqindmijë) Euro, dhe K.i e ka bërë autorizimin, M. P. dhe ia dërguar në Kosovë nga se në atë kohë K.i kishte qenë në Tiranë dhe këtë e kam kuptuar sipas fjalëve të M., pra kjo punë ka qenë rreth fundi i Gushtit 2010. Ai ka shtuar se kur në jetën time asnjëherë nuk e kam kërcënuar K. nga se kam pasur respekt për të dhe asnjëherë nuk jam kërcënuar atij ndërsa djalit të tij B. është e vërtetë që ia kam dërguar mesazhin që është i shënuar në telefon dhe kjo për mua nuk ka qenë kërcënim por ka qenë tërheqje e vërejtjes për faktin se B. mi ka kërkuar 5.000 (pesëmijë) Euro borxh dhe të njëjtit i kam thënë se



B. pas 10 dite kam me e martuar vajzën time dhe më duhen paratë për përcjelljen e vajzës e i pasi i njëjti mi ka marr paratë, kam tentuar me e thirr në telefon, nuk e hapte telefonin dhe pastaj ia kam dërguar këtë mesazh dhe këto para për të cilat theksova nuk kanë të bëjnë fare me rastin për të cilin sot akuzohem. Ai ka shtuar se prokurën e ka marr M. P. dhe pastaj M. P. e ka bërë pra kontratën e shitblerjen e shtëpisë, e ka nënshkruar M. P. si shitës i autorizuar i K. D. dhe unë U. D. blerës. Ai ka shtuar se kontratën e nënshkruar e ka marr M. P. dhe kemi shkuar afër restorantit “...” dhe nuk e di ka hy ai në një shtëpi dhe mua më ka thënë se po i marr çelësat tek gruaja e K. D., pastaj i ka marr çelësat e kam shikuar shtëpinë, ka pasur aty disa mobile por ka qenë parketi i dhomës së pritjes i qar dhe ka filluar ta rregulloi, në të cilën kamë investuar 3.000 ( tremijë) Euro, ai ka theksuar se në atë shtëpi ka qëndruar 5 ose 6 muaj, nuk e di saktësisht. Ai ka shtura se K. D. dhe djali i tij B. kanë ikur nga shtëpia për shkak borxheve që kanë pasur dhe unë kur kam marr shtëpinë e K. D.t, ka ardhur një person nga fshati M., dhe ka vendos një pllakate dhe ka shënuar se kjo është shtëpia ime me emër dhe mbiemër, dhe unë e kam thirrë përmes telefonit dhe i kam thënë se kjo shtëpi është e imja në bazë të kontratës dhe unë kamë hy të banoi në të dhe ka ikë prej kërcënimeve shumë të mëdha dhe nuk e di pse ka gjete me më pru këtu kur nuk e kam kërcënuar, dhe rasti i dytë unë vetë personalisht kam pasur një kërcënim prej dy vëllezërve nga Mitrovicës duke më thënë se gjallë apo të vdekur nuk të lejojmë me e shitë shtëpinë e K. D. nga se më ka borxh 200.000 (dyqind mijë) Euro, më ka marr mobile dhe emrat e këtyre personave i di vetë K. D., nga se mua nuk mi kanë treguar emrat. Ai ka shtuar se është e vërtetë se ia kam dërguar djalit të K., D. B.t mesazhin me tekstin se “o ti je ka lyp me ardhur me të shti në gepek të kerrit e me të tregu pse nuk e hap telin”, nga se kam qenë i revoltuar për faktin se nuk e ka hapur telefonin dhe unë kam pasur përcjelljen e vajzës dhe kur i kam dhënë parat B. 5.000 (pesëmijë) Euro, i kam treguar se me këtë datë kam për ta paguar restorantin dhe këtë mesazh e kam shkruar kur ata kanë qenë në Gjakovë.

#### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 267 paragrafi 1 të KPK, është parashikuar se veprën penale të detyrimit e kryejnë “*Kushdo i cili me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme përdor forcën apo kërcënimin e rëndë për ta detyruar personin tjetër që të veprojë apo të mos veprojë në dëm të pasurisë së vet a të pasurisë së personit tjetër dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet*”. Vepra penale e detyrimit qëndron në detyrimin e tjetrit me forcë apo me kanosje serioze që të veprojë apo të mos veprojë. Pra Veprimi i kryerjes së veprës penale është detyrimi i ndonjë personi për një veprim apo mosveprim të caktuar e që nënkupton ndikimin e dhunshëm në vullnetin e ndonjë personi, realizimi të tjetrit i vendimit të imponuar përkitazi me një sjellje të caktuar. Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte, në të cilën duhet të ekzistojë edhe qëllimi për përfitim të dobisë pasurore të kundërligjshme.

#### 5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk duhet t’i falet besimi deklaratimit të akuzuarit U. D. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor me të cilin mohon kryerjen e veprës penale ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate kjo bëhet thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Gjykata nuk ia ka falur besimin deklaratimin e të akuzuarit U. D. për shkak se deklaratimi i tij është në kundërshtim me provat të cilave gjykata iu ka falë besimin e siç janë: dëshmitë e të dëmtuarve K. D., B. D., G. D. por edhe të dëshmitarëve M. P. dhe N. D., si me para kontratën së shitblerjes së patundshmërisë e datës 25.08.2010, prokura e posaçme me numër ... të datës 24.08.2010, deklaratën e M. P.t me numër ...e datës 13.09.2010 dhe raportin e ekspertimit të Agjencinë Kosovare për Forenzikë me numër ...i datës 17.05.20.... I akuzuari U. D. ka mohuar faktin se me kanosje të vazhdueshme ka detyruar të dëmtuarit K. D. me djalin B. të e largohen nga Gjakova, edhe pse në emër të fajdesë kishte paguar 145.000 Euro

për borxh dhe 21.000 Euro fajde për automjetet e shitura dhe me datën 23.08.2010 i dëmtuari K. detyrohet të ia jep prokurën dëshmitarit M. P. t që në emër të tij të lidhë kontratë me të akuzuarin U. D. kinse mbi shitblerjen e shtëpisë në rrugën “...” nr.14. Një pretendim i tillë i të akuzuarit U. D. nuk qëndron ngase kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarave K., B., G. D., por dhe dëshmitares N. D., për shkak se dëshmitë e tyre është kuptimplotë dhe ajo çka është shumë e rëndësishme, deklaratat e tyre përputhet në tërësi me deklaratimet e tyre të dhëna në Polici dhe në Prokurori. Për gjykatën nuk ka qenë kontestuese fakti se i akuzuari U. D. e kishte kërcënuar vazhdimësi të dëmtuarin K. D. në forma të ndryshme duke e detyruar kështu të njëjtin t’ia bartë shtëpinë në emër të tij. Po ashtu i njëjti e kishte kanosur edhe të dëmtuarin B. D. duke i dërguar mesazh në telefon me tekstin se *“o ti je ka lyp me të ardhë me të shti në gepek të kerrit e me të tregu pse nuk e hap telin”* ku për shkak të këtyre kërcënimeve të dëmtuarit K. dhe B. D. ishin detyruar të ikin në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht në Tiranë. I dëmtuari K. D. në vazhdimësi edhe në Tiranë, kishte pranuar telefonata kërcënuese nga i akuzuari U. D., ashtu që i njëjti për shkak të këtyre kërcënimeve ishte detyruar të ta nënshkruar edhe Prokurën e posaçme me numër ... të datës 24.08.2010, përmes të cilës e kishte autorizuar dëshmitarin M. P. që ia kishte dhënë të drejtat dhe kompetencat të plota që në emër të tij dhe në llogari të tij të kryej veprime juridike dhe administrative siç janë: të përfaqësoi në të gjitha institucionet shtetërore, zyrën e pasurive dhe paluajtshmerive në Gjakovë, të tërheq vërtetimin e pronësisë në emër të tij të nënshkruar kontrata të shitblerjes në cilësi të shitësit ku është pronar i dy paluajtshmerive ku është pronar i të dy pasurive të paluajtshme, me emërtimin apartamentit banimi me oborr dy katëshe e ndodhur në rrugën “...” si dhe dyqani i ndodhur në rrugën “I. Q.” një katëshe kati I. Dëshmitari M. P. me të marr prokurën nga i dëmtuari K. D., në cilësi të përfaqësuesit të autorizuar kishte shitur shtëpinë e të dëmtuarit K. D. këtu të akuzuarit U. D. ashtu që i njëjti kishte nënshkruar para kontratën përmes të cilës M. P., përmes prokurës së posaçme me numër ... të datës 24.08.2010 të vërtetuar tek notari H. G., në cilësi të shitësit, blerësit këtu të akuzuarit U. D. nga Gjakova ia shet pjesën ideale e 2/5 të patundshmërisë e cila është evidentuar në ngasjen kadastrale me numër ....me kulturë shtëpi dhe oborr në Gjakovë. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate i akuzuari U. D., kishte hyrë në shtëpinë e të akuzuarit K. D., duke i larguar nga shtëpia bashkëshorten e të dëmtuarit K. dhe dy vajzat e tij ashtu që i njëjti tij kishte qëndruar në shtëpinë e të dëmtuarit K. D. për afër 1 vit e 2 muaj. Kjo është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit K. D. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: *kam dhënë një prokurë tek noteri në Tiranë dhe ia kam dërguar në Gjakovë tek i autorizuari im M. P., arsyeja ka qenë se i akuzuari U. D. nga unë ka kërkuar prapë fajde duke thënë se është rritur vlera dhe duke më dërguar mesazhe telefonike kërcënuese. Në Shqipëri kam ikur për shkak të presionit të U.s dhe kur ka kaluar rasti im tek Eulexi pastaj jam kthyer në shtëpi. Duke i parë këto kërcënime e kam autorizuar M. P. n duke i thënë se meqenëse po kërkon shtëpinë ... me kërcënime, po ta dërgoi prokurën por në atë shtëpi është hisetarë motra ime G., gjithashtu shtëpia është në hipotek në bankë. Por pavarësisht kësaj ai mi ka marr çelësat e shtëpisë është futur në shtëpi U. D. dhe bashkëshortja dhe fëmijët kanë dalë në rrugë. Për atë sa kam dijeni M. P., nuk ka vepruar sipas prokurës. Shtëpia ime gjendjet në rrugën “...” nr..... I akuzuari U. D. shtëpinë e ka mbajtur saktësisht kohën nuk e di por e ka mbajtur mund të them 2 deri në 3 vite. Edhe i dëmtuari B. D. gjatë dëshmisë së tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: *në Shqipëri kemi ikur me babain tim K. D. nga se kemi qenë të kërcënuar duke filluar nga ... i cili më ka shkruar mesazh në telefon në numrin ..., dhe më ka thënë po nuk i prunë parat e fajdesë sot kam me të futë në gepek dhe sendet tjera. Kemi pasur edhe një rast lidhur me vëllain e U. – M., djalin e U., i cili gjendjet në Zvicër si dhe P., të cilët me kanë ndjekur në B. të R. afër Hotelit “...”, më kanë zbrit nga automjeti, më kanë mbajtur 2 orë e gjysmë në bagazh duke më sjellë herë në fshatin N. dhe herë nëpër qytete duke më thënë se nëse nuk vijnë babai dhe halla me e nënshkruar tokën dhe me na kthyer paratë nga se është rritur shuma e tyre ngase ata thonin se këto para i kanë marr në Shqipëri nga dikush tjetër dhe unë nuk kam pasur zgjidhje tjetër dhe atë ditë babai imë nuk ka qenë në Gjakovë dhe kam qenë i detyruar që të shkoj tek M. P. i cili e ka pasur lokalin tek “K., dhe aty ka dal M. dhe i kam treguar për rastin dhe M. ka biseduar një herë me babain tim dhe ka marr përgjegjësi që nesër unë ju takojë me babain tim K., veç lëshoni djalin. Edhe i dëmtuara G. D. gjatë dëshmisë së saj**

në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: *Çelësat e shtëpisë ia ka dorëzuar bashkëshortja e K. N. M. P., edhe pse unë nuk kam dashur që ti jap çelësat por N. ka kundërshtuar nga se kishte frikë për djalin e saj B. që mos po i bëjnë diçka dhe ajo më ka thënë se i kanë thanë djalit B. se të marrim dhe të ngrehim zhag me makinë nëse nuk e lëshon shtëpinë, dhe një herë B. e kanë kindapuar. për disa orë M. D., P. Gj.dhe djali i U. D.. Këtë kërcënim e ka bërë ... dhe me sa më duket e ka bërë përmes telefonit por unë këtë kërcënim personalisht nuk e kam dëgjuar. Edhe dëshmitarja N. D. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se djali më ka thënë se i akuzuari iu ka dhënë para me fajde dhe për shkak të presionit duhet me e liruar shtëpinë për shkak se i ka dërguar disa mesazhe kërcënuese se do të ju ngrehi zhag dhe do të iu shti në makinë por edhe në disa raste tjera, që nuk i di dhe se nuk më kanë treguar mua për këtë gjë ashtu që është dashur me vajzat e mia që të largohem nga shtëpia dhe vetëm me rrobat jemi larguar nga shtëpia. Edhe vet i akuzuari nuk e kishte mohuar faktin se kishte qenë numri i tij i telefonit ai cili ia kishte dërguar mesazhin të dëmtuarit B. D.me tekstin “o ti je ka lyp me të ardh me të shti në gepek të kerrit e me të tregu pse nuk e hap telin. Ky fakt është vërtetuar edhe nga raportit të ekspertimit të Agjencinë Kosovare për Forenzikë me numër ...i datës 17.05.20... së bashku me CD-në, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes numrit të telefonit ..., i cili numër kishte qenë numri i telefonit të akuzuarit U. D.i cili përmes mesazhit “o ti je ka lyp me të ardh me të shti në gepek të kerrit e me të tregu pse nuk e hap telin” me këtë mesazh iu kishte drejtuar të dëmtuarit B. D..*

Gjykata me pajtimin e palëve ka dëgjuar edhe dëshmitarët A. D., I. A. dhe F. M. ashtu që dëshmitë e këtyre dëshmitarëve gjykata i ka vlerësuar si dëshmi të rëndësishme irelevante për rastin dhe kanë qenë dëshmi rreth në takimi në mes të akuzuari U. D.dhe të dëmtuarit K. D. lidhur me borxhin.

#### 6. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari U. D.ka kryer veprën penale të detyrimit nga neni 267 par.1 të KPK-së, në atë mënyrë që me qëllim që vetes apo personit tjetër t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme duke përdor forcën por kërcënimin e rëndë ka detyruar të dëmtuarin K. D. që të veprojë në dëm të pasurisë së vet dhe të pasurisë së personit tjetër të dëmtuarës G. D. duke e detyruar që ia shtëpinë, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të pjesës gjyqësore të aktgjykimit.

#### 7.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit U. D., gjykata vlerësoji të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të neni 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale për të akuzuarit: është mbajtes si familjes, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, faktin se me parë ka ra ndesh me ligji më parë nuk ka qenë i dënuar me parë. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 34 dhe qëllimi i dënimit me kusht nga neni 42 të KPK-së, dhe se dënimi si i tilla i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, dhe se dënimi konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 8.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Gjykata në kuptim të nenit 463 paragrafi 2 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marr vendim mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.550/11, me datë 30.07.20...**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.